


SHPREHU LIRSHËM



AKTIVITETET E FËMIJËVE AKTIVË

DARIS (11), BUNA (11), VALENTIN (12), AMIR (11), VENERA (12), ANESA (11), VESA (11), ENEA (11),
YLLDRIT (11)



Ne jemi nxënësit e shkollës „MODEL“ të klasës VI-1 në Prishtinë dhe kemi punuar një artikull për demokracinë, qytetarët aktivë dhe se çka do të thotë të jesh qytetar aktiv

Fjala demokraci rrjedh nga fjala greke „demos“ - popull dhe nga fjala „kratia“ - udhëheqje, që do të thotë



udhëheqje nga populli. Demokracia për herë të parë ka filluar të zbatohet në Athinë në vitin 507 para erës së re. Qytetari aktive do të thotë kur një njeri ose një grup qytetarësh dalin vullnetarë për t'i ndihmuar njerëzve të varfër, atyre me nevoja të veçanta, marrin pjesë në ndonjë organizatë bamirëse, etj.

Qytetar i Kosovës do të thotë një njeri i cili banon ose jeton në Kosovë, ka të drejta të barabarta dhe i përmesh përgjegjësitë e veta si qytetar. Disa nga të drejtat

tona janë: e drejta e shkollimit, e drejta e familjes, e drejta e mësimi, e drejta e ushqimit, e drejta e lojës, e vendbanimit etj,

Unë në vendin tim mbaj përgjegjësi, nuk hedh mбетurina, mbaj pastër vendbanimin tim dhe mbaj qetësi. Ne duhet të respektojmë, po ashtu edhe disa rregullat të tjera të tilla si: rregullat e komunikacionit. Për shembull, kur ngasim veturën dhe kur duam të kalojmë rrugën të respektojmë semaforin. Gjatë Punëtorisë, ne mësuam se si të bashkëpunojmë në grup, të flasim me radhë dhe se çka duhet të bëjmë për të qenë qytetarë aktivë.



DEPUTETËT DHE PARLAMENTI


AMELA (11), BARDHI (11), BLENITA (11), DIONI (11), DRINI (12), ELDA (11), FUADI (11), GENTI (11), LAURJAN (11), UARDA (11)

Si zgjedhen deputetët në Kuvendin e Kosovës?


Përfaqësuesit e vendit tonë janë deputetët. Fjala deputet do të thotë përfaqësues, e kjo nënkupton se deputetët përfaqësojnë popullin që i ka votuar.

Të drejtën për t'u bërë deputet e gëzon secili qytetar që është mbi moshën 18 vjeçare. Kandidatët për deputetë jo domosdoshmërisht duhet t'i përkasin një partie politike, sepse mund të kandidojnë edhe si deputetë të pavarur. Ata kandidatë që marrin më së shumti vota zgjedhen deputetë dhe e përfaqësojnë popullin në Kuvend. Kuvendi i Kosovës ka 120 deputetë.

Ne sot mësuam se të gjithë deputetët duhet t'i respektojnë ligjet dhe të punojnë në përputhje me këto ligje. Vetëm kështu ndërtohet shteti ynë demokratik.




Kryetari i Kuvendit duke e lexuar deklaratën e betimit



Funksionet kryesore të Kuvendit



Duke i gjetur fjalët që lidhen me demokracinë




Planprogrami i njërit nga kandidatët për deputetë



Ne duke mësuar për Kuvendin dhe deputetët

PËRGJEGJËSITË E NDARJES SË PUSHTETIT

ENIS (11), ERTURAL(11), ENSAR (11), BLENDI (11), DINETA (10), ALBINA (11), OLSA (10), RIGONI (11),
ANDRRA (11), RINESA (11)



Ne mësuam...

Ne shprehim në këtë artikull se pse duhet të bëhet dhe të ekzistoj ndarja e pushtetit në një shtet i cili udhëhiqet sipas parimeve të demokracisë.

Në Kosovë të gjithë kemi të drejta të barabarta. Mirëpo, rregullat në përgjithësi kërkojnë respektimin dhe zbatimin e tyre. Rregullat e shtetit tonë quhen ligje. Ligjet propozohen nga Qeveria, Kuvendi, Presidenti, dhe nga mbi 10.000 qytetarë. Këto ligje miratohen në Kuvend. Po ashtu, në sistemin demokratik bëhet ndarja e pushtetit. Sipas nenit 4 të Kushtetutës të Kosovës Kuvendi ushtron Pushtetin Legjislativ, Qeveria ushtron Pushtetin Ekzekutiv, ndërsa gjykatat ushtrjnë Pushtetin Gjyqësor. Në Kuvend, përmes votave zgjedhet dhe shkarkohet Kryetari i kuvendit. Gjithashtu, në Kuvend miratohet buxheti i vendit përmes votave

të deputetëve, të cilët punojnë aty. Ndërsa, Qeverinë e përbëjnë Kryeministri, zv. kryeministrat dhe ministrat. Të gjithë qytetarët janë të barabartë para ligjit.



Në fund, në gjykatë bëjnë pjesë: gjykatësi, prokurori, avokati dhe i akuzuari.



ZGJEDHJET NË DEMOKRACI


HANA (11), BENARA (11), FISNIK (11), JON (11), GENCI (11), VIOLA (11), ELMEDINA (11),
OLTA (11), ERLIND (11)

Voto, që të kesh një të ardhme më të mirë!

Demokracia është një formë e qeverisjes, ku çdo njeri ka të drejta të barabarta, pa dallim feje, race, gjinie, etj. Çdo njeri që kur ka lindur ka pasur të drejtën e votës, por ajo praktikohet vetëm mbi moshën 18 vjeçare. Demokracia ndahet në: demokraci të drejtpërdrejtë dhe demokraci përfaqësuese. Demokracia përfaqësuese ndahet në dy sisteme: sistemi parlamentar dhe sistemi presidencial.

Në Kosovë funksionon sistemi parlamentar, ku qytetarët në mënyrë demokratike votojnë në mënyrë të fshehtë dhe të pavarur.

Përfaqësuesit e qytetarëve janë deputetët, të cilët në mënyrë të denjë i përfaqësojnë kërkesat e qytetarëve.



Rëndësia e votës



Demokracia bën fuqinë





IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë: Pjesëmarrësit:
Tel: +381 38 704 560 SHFMU „MODEL“
E-mail: info@demos-ti.org Klasa: VI-1
Website: www.demos-ti.org Vendi: Prishtinë